

AKT NORMATIV
Nr. 6, datë 12.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10487, DATË 5.12.2011
“PËR BUXHETIN E VITIT 2012”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.10487, datë 5.12.2011, “Për buxhetin e vitit 2012”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2012 është:

Të ardhurat	332 758	milionë lekë;
Shpenzimet	382 296	milionë lekë;
Deficiti	49 538	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2012 është:

Të ardhurat	263 172	milionë lekë;
Shpenzimet	312 710	milionë lekë;
Deficiti	49 538	milionë lekë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2012 është:

Të ardhurat	27 049	milionë lekë;
-------------	--------	---------------

Nga të cilat:

Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror	13 876	milione lekë;
Të ardhurat	13 173	milione lekë;
Shpenzimet	27 049	milione lekë.”.

Neni 4

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2012 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej	83 360	milione lekë;
-----------------------	--------	---------------

Nga të cilat:

- kontributet	50 287	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	33 073	milione lekë;
- shpenzimet	83 360	milione lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategoritë specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transfertat e buxhetit të shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2012, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 405	milione lekë;
-----------------------	-------	---------------

Nga të cilat:

- kontributet	290	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 115	milione lekë;
- shpenzimet	5 405	milione lekë.”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	4 020	milione lekë;
---------	-------	---------------

Të ardhurat tatimore	235 922	milione lekë;
Të ardhurat jotatimore	23 230	milione lekë.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 49 538 milionë lekë, nga i cili 900 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 48 638 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Çdo e ardhur nga privatizimi, e arkëtuar mbi shumën e parashikuar në këtë ligj, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime dhe uljen e huamarrjes, e cila, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korente	241 365	milione lekë;
Shpenzimet kapitale	64 690	milione lekë;
Fondi rezervë	1 800	milione lekë;
Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit	2 600	milione lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensione	2 255	milione lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, të transferohet në llogarinë e shpronësimeve për interesa publikë.”.

Neni 8

Në nenin 11, shuma e fondit të veçantë, prej 1931 milionë lekësh, ndryshohet në 1145 milionë lekë.

Neni 9

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, prej 1 800 milionë lekësh, përdoret për raste të

paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit, prej 2 600 milionë lekësh, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave. Fondi për rritjen e pagave e të pensioneve, prej 2 255 milionë lekësh, shpërndahet nga ministri i Financave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 10

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, është 87,740 milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, për mbështetjen buxhetore, deri në 26,290 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto, për financimin e projekteve të huaja, deri në 46,000 milionë lekë.

Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 13,700 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja, të papaguara, deri në 1,750 milionë lekë.

4. Niveli i stokut të borxhit shtetëror parashikohet të arrijë deri në 792,694 milionë lekë, ndërsa niveli i stokut të garancive deri në 62,683 milionë lekë.”.

Neni 11

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 12

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha